

Ligj për standardin e studentëve

Ligj për standardin e studentëve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 15/2013; 30/2013; 120/2013 dhe 41/2014).

I. DISPOZITA THEMELORE

Neni 1

Me këtë Ligj rregullohen veprimtaria e standardit të studentëve, themelimi, organizimi, funksionimi dhe menaxhimi në institucionet për standardin e studentëve si pjesë e sistemit të arsimit dhe dhënia e bursave studenteve.

Neni 2

(1) Standardi i studentëve realizohet në institucione për standard të studentëve të cilat organizohen si konvikt shtetëror i studentëve dhe konvikt privat i studentëve (në tekstin e mëtejshëm: konvikte të studentëve).

(2) Konviktet e studentëve themelohen për realizim të interesave dhe nevojave për qëndrim të studentëve të cilët studiojnë jashtë vendbanimit të tyre.

(3) Konviktet e studentëve kanë cilësi të personit juridik dhe regjistrohen në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë.

Neni 3

Veprimtaria e standardit të studentëve që realizohet në konviktet e studentëve është me interes publik.

Neni 4

Çdo student i rregullt, me kushte të barabarta të përcaktuara me këtë ligj, ka të drejtë të qëndrojë në konvikt të studentëve.

Neni 5

(1) Në konviktin e studentëve është i ndaluar arsimi fetar, si dhe organizimi dhe veprimi politik dhe religjioz.

(2) Në hapësirat e konviktit të studentëve ndalohet paraqitje e simboleve partiake dhe fetare.

Neni 6

(1) Konvikti i studentëve ka vulë.

(2) Në mesin e vulës është stema e Republikës së Maqedonisë, ndërsa anash emri i Republikës së Maqedonisë dhe emri dhe selia e konviktit të studentëve.

Neni 7

(1) Konvikti i studentëve ka statut.

(2) Pëlqim të statutit të konviktit shtetëror të studentëve jep Ministria e Arsimit dhe Shkencës (në tekstin e mëtejme: Ministria).

(3) Pëlqim të statutit të konviktit privat të studentëve jep themeluesi.

Neni 8

Qeveria e Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtejme: Qeveria), në pajtim me dokumentet zhvillimore, miraton program për realizim dhe zhvillim të veprimtarisë së standardit të studentëve.

Neni 9

Me standard të studentëve sipas këtij ligji, nënkuptohen sigurimi i vendosjes, ushqimit, shpenzimeve të shkollimit, bursave, si dhe plotësimi i nevojave kulturore, informative, rekreativo-sportive dhe nevojave tjera të përbashkëta të studentëve.

Neni 10

(1) Konvikti i studentëve është institucion i cili studentëve u siguron vendosje, ushqim, kujdes për shëndetin, aktivitete kulturore festive, rekreative sportive dhe të tjera.

(2) Për studentët mund të organizohet vendosje edhe në konvikt privat të studentëve.

(3) Nëse në konviktin e studentëve mbetën vende të lira mund të plotësohen me nxënës të rregullt nga shkollat e mesme në pajtim me Ligjin për standardin e nxënësve.

II. THEMELIMI DHE PUSHIMI I PUNËS SË KONVIKTEVE TË STUDENTËVE

Neni 11

(1) Konvikt shtetëror të studentëve themelon Qeveria.

(2) Konvikt privat të studentëve mund të themelojë personi fizik ose juridik i vendit ose i huaj në bazë të licencës, në pajtim me këtë ligj.

Neni 12

(1) Kushte për themelim të konviktit shtetëror të studentëve janë:

- numri i mjaftueshëm i studentëve,
- të sigurohen mjete të nevojshme për themelim dhe punë,
- të sigurohen pajisje, hapësirë dhe kuadër adekuat dhe
- kushte tjera të përcaktuara me ligj.

(2) Kushtet e përmendura në paragrafin (1) alinetë 2, 3 dhe 4 të këtij neni vlejné edhe gjatë themelimit të konvikteve private të studentëve.

(3) Normativat dhe standardet për pajisje, hapësirë dhe kuadër i përcakton ministri kompetent për punët nga fusha e arsimit (në tekstin e mëtejshëm: ministri).

(4) Dispozitat më të afërta për ushqim të studentëve në konviktet e studentëve i përcakton ministri në bazë të mendimit nga institucioni kompetent i kësaj veprimtarie.

Neni 13

(1) Krahas kushteve të caktuara në nenin 12 të këtij ligji, për themelim të konviktit privat të studentëve themeluesi duhet të parashtojë garanci bankare se do të jetë në gjendje t'i kompensojë mjetet të cilat studentët ia kanë paguar konviktit privat të studentëve që ka pushuar së punuari dhe shpenzimet tjera të cilat do t'i kenë studentët për shkak të transferimit në konvikt tjetër të studentëve në Republikë.

(2) Lartësinë e garancisë bankare nga paragrafi (1) i këtij neni, e përcakton ministri varësisht nga numri i studentëve të pranuar në konviktin e studentëve, si dhe nga lartësia e kompensimit që paguhet për vendosje dhe ushqim të studentëve.

Neni 14

Procedura për themelim të konviktit privat të studentëve fillon me parashtrimin e kërkesës për leje për themelim të konviktit privat të studentëve me të cilin parashtrohet elaborat për themelim dhe propozim të aktit themelues për themelim të konviktit privat të studentëve.

Neni 15

(1) Elaborati për themelim të konviktit privat të studentëve veçanërisht i përmban: të dhënat për themeluesin, numrin e shtretërve për student, kushtet hapësinore dhe pajisjen për realizim të veprimtarisë, burimin e mjeteve financiare për kryerjen e veprimtarisë, mundësinë për sigurim të numrit të nevojshëm të kuadrove që mund të jenë të punësuar në konviktin e studentëve dhe planin për mënyrën se si do të plotësohen kushtet të cilat janë caktuar në normativat dhe standardet për themelim të konviktit privat të studentëve.

(2) Kërkesa për leje për themelim të konviktit privat të studentëve me elaboratin për themelim të konviktit privat të studentëve dhe propozim-akti themelues për themelim të konviktit privat të studentëve parashtrohet në Ministri.

(3) Për konfirmimin e përmbushjes së kushteve nga nenet 12 dhe 13 të këtij ligji, ministri formon komision prej dy përfaqësuesve të Ministrisë dhe një përfaqësuesi të Inspektoratit Shtetëror të Arsimit.

Neni 16

Vendim për dhënie të lejes për themelim të konviktit të studentëve merr Qeveria pas mendimit paraprak nga Ministria, nëse janë plotësuar kushtet e përcaktuara në nenet 12 dhe 13 të këtij ligji.

Neni 17

Me vendimin nga neni 16 i këtij ligji përcaktohen:

- kuadri i duhur, pajisja dhe hapësira sipas normativave dhe standardeve të caktuara,
- numri i shtretërve të studentëve dhe
- fillimi i punës së konviktit të studentëve.

Neni 18

Themeluesi është i obliguar që gjatë themelimit të konviktit të studentëve të formojë komision i cili në pajtim me ligjin kryen përgatitje për fillim me punë të konviktit të studentëve.

Neni 19

(1) Konvikti i studentëve fillon me punë pas marrjes së aktvendimit për verifikim.

(2) Aktvendimin për verifikime e miraton Ministria.

(3) Lidhur me kërkesën e parashtruar për verifikim Ministria merr aktvendim për verifikim, përkatësisht aktvendim për refuzim të kërkesës për verifikim në afat prej 60 ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës.

(4) Kundër aktvendimit nga paragrafi (2) të këtij neni, mund të parashtrohet ankesë te Komisioni Shtetëror për Vendosije në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

(5) Ministria mban Regjistër të konvikteve të studentëve të themeluara në territorin e Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtejme: Regjistër).

(6) Mënyrën e verifikimit të konviktit të studentëve, si dhe formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit nga paragrafi (5) i këtij neni, i përcakton ministri.

Neni 20

(1) Nëse Ministria nuk miraton vendim për verifikim, respektivisht nuk miraton vendim për refuzimin e kërkesës për verifikim në afatin e përcaktuar në nenin 19 paragrafi (3) e këtij ligji, parashtruesi i kërkesës ka të drejtë që në afat prej tri ditëve të punës nga skadimi i këtij afati të parashtojë kërkesë të sekretaria e ministrit për miratimin e vendimit nga ana e ministrit.

(2) Formën dhe përmbajtjen e kërkesës nga paragrafi (1) i këtij neni, i përcakton ministri.

(3) Ministri, është i obliguar që brenda pesë ditësh pune nga dita e paraqitjes së kërkesës nga paragrafi (1) i këtij neni në sekretarinë e ministrit, të miratojë vendim me të cilin kërkesa për miratimin e vendimit për verifikim është pranuar ose refuzuar. Nëse ministri nuk ka sekretari, kërkesa parashtrëhet në sekretarinë e selisë së Ministrisë.

(4) Me kërkesë për miratimin e aktvendimit nga paragrafi (1) i këtij neni, parashtruesi i kërkesës dorëzon kopje nga kërkesa për miratimin e vendimit për verifikim nga neni 19 paragrafi (2) i këtij ligji.

(5) Nëse ministri nuk miraton aktvendim në afatin nga paragrafi (3) i këtij neni, parashtruesi i kërkesës mund ta njoftojë Inspektoratin Shtetëror Administrativ në afat prej pesë ditëve të punës.

(6) Inspektorati Shtetëror Administrativ është i obliguar që në afat prej dhjetë ditëve nga dita e pranimit të njoftimit nga paragrafi (5) i këtij neni, të kryejë mbikëqyrje në Ministri nëse është zbatuar procedura në pajtim me ligjin dhe në afat prej tri ditëve të punës nga dita e mbikëqyrjes ta informojë parashtruesin e kërkesës për gjendjen e konstatuar gjatë mbikëqyrjes së kryer.

(7) Inspektori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ të paragrafit (6) të këtij neni, pas mbikëqyrjes së kryer në përputhje me ligjin, merr aktvendim me të cilin e obligon ministrin që brenda dhjetë ditësh të vendosë për kërkesën e parashtruar, përkatësisht ta pranojë ose refuzojë kërkesën dhe për masat e marra në të njëjtin afat të informojë inspektorin dhe t'i dorëzojnë një kopje të aktit me të cilin është vendosur për kërkesën.

(8) Nëse Ministri nuk vendos në afatin nga paragrafi (7) të këtij neni, inspektori do të parashtojë kërkesë për iniciimin e procedurës kundërvajtëse për kundërvajtje të caktuar në Ligjin për inspektim administrativ dhe do të caktojë afat plotësues prej pesë ditëve të punës, në të cilin ministri do të vendosë për kërkesën e parashtruar për çfarë në afatin e njëjtë do ta njoftojë inspektorin për aktin e miratuar. Me njoftim dorëzohet kopje nga akti me të cilin ka vendosur për kërkesën e parashtruar. Inspektori në afat prej tri ditëve të punës e informon parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

(9) Nëse ministri nuk vendos edhe në afatin shtesë nga paragrafi (8) i këtij neni, inspektori në afat prej tri ditëve të punës do të parashtojë kallëzim të prokurori publik kompetent dhe në këtë afat do ta informojë parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

(10) Nëse inspektori nuk vepron për njoftimin nga paragrafi (6) i këtij neni, parashtruesi i kërkesës në afat prej pesë ditëve të punës, ka të drejtë të parashtojë ankesë të sekretaria e

drejtorit të Inspektoratit Shtetëror Administrativ. Nëse drejtori nuk ka sekretari, kërkesa parashtrohet në sekretarinë e selisë së Inspektoratit Shtetëror Administrativ.

(11) Drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ është i obliguar që në afat prej tri ditëve të punës nga dita e pranimit që ta shqyrtojë ankesën nga paragrafi (10) i këtij neni dhe nëse konstaton se inspektori nuk ka vepruar sipas njoftimit nga parashtruesi i kërkesës nga paragrafi (6) i këtij neni ose nuk ka paraqitur kallëzim sipas paragrafit (9) të këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ do të parashtojë kërkesë për inicimin e procedurës kundërvajtëse për kundërvajtje të përcaktuar në Ligjin për inspektim administrativ dhe do të përcaktojë afat plotësues prej pesë ditëve të punës në të cilin inspektori do të kryej mbikëqyrje në Ministri nëse është zbatuar procedura në pajtim me ligjin dhe në afat prej tri ditëve të punës nga dita e mbikëqyrjes së kryer ta informojë parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

(12) Nëse inspektori nuk vepron edhe në afatin shtesë nga paragrafi (11) i këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ në afat prej tri ditëve të punës do të parashtojë kallëzim të prokurori publik kompetent dhe në afat prej tri ditësh do ta informojë parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

(13) Në rastin nga paragrafi (12) të këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ menjëherë, e më së voni në afat prej një ditë punë, do të autorizojë inspektor tjetër që ta kryejë mbikëqyrjen menjëherë.

(14) Në rastin nga paragrafi (13) i këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ në afat prej tri ditëve të punës do ta informojë parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

(15) Nëse drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ nuk vepron në pajtim me paragrafin (11) të këtij neni, parashtruesi i kërkesës mund të parashtojë kallëzim te prokurori publik në afat prej tetë ditëve të punës.

(16) Nëse ministri nuk vendos në afatin nga paragrafi (8) i këtij neni, parashtruesi i kërkesës mund të ngritë kontest administrativ para gjykatës kompetente.

(17) Procedura para Gjykatës Administrative është urgjente.

Neni 21

(1) Qeveria mund që ta heqë lejen për themelimin e konviktit privat të studentëve me propozim të Inspektoratit Shtetëror të Arsimit, nëse:

- themeluesi, themelon konvikt privat të studentëve në kundërshtim me vendimin nga neni 16 i këtij ligji dhe

- konstatohet se institucioni privat tanimë nuk i plotëson kushtet nga nenet 12 dhe 13 të këtij ligji ose nuk i zbaton dispozitat e këtij ligji dhe aktet nënligjore që dalin prej tij.

(2) Leja për themelimin e konviktit privat të studentëve mund të shfuqizohet edhe me kërkesën e themeluesit.

Neni 22

- (1) Në ditën e miratimit të aktit për marrjen, respektivisht shfuqizimin e lejes, konvikti privat i studentëve pushon nga puna.
- (2) Në bazë të aktit për marrjen, respektivisht shfuqizimin e lejes, konvikti privat i studentëve fshihet nga regjistri nga neni 19 paragrafi (5) i këtij ligji.
- (3) Themeluesi është i obliguar që studentëve të konviktit privat të studentëve që pushon së punuari t'u sigurojë vendosje dhe ushqim përkatës në llogari të themeluesit deri në fund të vitit studimor.
- (4) Akti na paragrafi (2) i këtij neni shpallet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".
- (5) Themeluesi pas miratimit të aktit për shuarjen e punës së konviktit të studentëve, brenda tri ditëve nga dita e hyrjes në fuqi të aktit, e njofton Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë për fshirjen e konviktit të studentëve nga regjistri adekuat.

III. PROGRAMI I PUNËS

Neni 23

- (1) Puna në konviktet e studentëve gjatë vitit studimor përcaktohet me program vjetor.
- (2) Programin vjetor të punës së konvikteve shtetërore të studentëve e miraton këshilli drejtues i konviktit të studentëve me propozimin të drejtorit të konvikt të studentëve më së voni deri më 1 nëntor të vitit rrjedhës.
- (3) Programin vjetor të punës së konvikteve private të studentëve e miraton organi udhëheqës i konviktit me propozim të drejtorit të konvikt të studentëve më së voni deri më 1 nëntor të vitit rrjedhës.

IV. STUDENTËT

Neni 24

- (1) Të drejtë vendosjeje dhe ushqimi në konviktet shtetërore të studentëve kanë studentët që shkollohen jashtë vendbanimit të tyre.
- (2) Regjistrimi dhe pranimi në konviktet shtetërore të studentëve kryhet përmes konkursit që e shpall Ministria në mjetet e informimit publik më së voni deri më 15 korrik.
- (3) Regjistrimi dhe pranimi i studentëve në konviktet private të studentëve bëhet përmes konkursit, që e publikon themeluesi.

(4) Konkursët nga paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni shpallen në mjetet e informimit publik që botohen në gjuhën maqedonase dhe në mjetet e informimit publik që botohen në gjuhën që e flasin së paku 20% të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë në njësinë e vetadministrimit lokal.

(5) Konkursi nga paragrafi (2) i këtij neni i përmban kriteret në vijim për pranimin e studentit: suksesin në mësim, rregullshmërinë në studime dhe gjendjen familjare materiale të studentit. Në konkurs përmbahen edhe numri i vendeve në disponim, dokumentet e nevojshme dhe afatet për paraqitje në konkurs për regjistrimin e studentëve në konviktet e studenteve dhe afati për vendosjen në konviktet e studentëve.

(6) Nga numri i vendeve në disponim në konviktin shtetëror të studentëve 40% të vendeve janë për studentë nga neni 25 paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji, kurse 25% janë për studentë që kanë arritur sukses veçanërisht të lartë në mësim.

(7) Studentët për pranim në konvikt shtetëror të studentëve parashtrojnë fletëparaqitje elektronike, që është e pranishme në faqen e internetit të Ministrisë.

Neni 25

(1) Gjatë vlerësimit me pika të fletëparaqitjeve të parashtruara elektronike nga neni 24 paragrafi (7) i këtij ligji, fëmijët pa prindër dhe përkujdesje prindërore, fëmijët me nevoja të veçanta, fëmijët shfrytëzues të ndihmës sociale në para dhe ndihmës së përhershme në para, fëmijët e prindit vetëmbajtës, fëmijët e prindërve të papunësuar, fëmijët e shfrytëzuesve të kompensimit në bazë të pushimit të marrëdhënies së punës për shkaqe afariste, për të cilët të hyrat e përgjithshme në familje janë deri në pagën minimale të përcaktuar në Republikën e Maqedonisë, marrin deri në 100 pika, varësisht nga suksesi në mësim dhe/ose kohëzgjatja e marrjes së ndihmës sociale në para dhe ndihmës së përhershme në para, përveç fëmijëve pa prindër dhe përkujdesje prindërore dhe fëmijëve me nevoja të veçanta për të cilët të hyrat e përgjithshme në familje mund të jenë edhe mbi pagën minimale të përcaktuar në Republikën e Maqedonisë.

(2) Gjatë vlerësimit me pika të fletëparaqitjeve të parashtruara elektronike nga neni 24 paragrafi (7) i këtij ligji, fëmijët e prindit vetëmbajtës, fëmijët e prindërve të papunësuar dhe fëmijët e shfrytëzuesve të kompensimit në bazë të pushimit të marrëdhënies së punës, kompensimi në bazë të pushimit të marrëdhënies së punës për shkaqe afariste për të cilat të hyrat e përgjithshme në familje janë mbi pagën minimale të përcaktuar në Republikën e Maqedonisë, marrin deri 50 pika vlerësohen me 50 pika për gjendjen familjare materiale të studentit. [2](#)

(3) Mënyrën e pranimi të studentëve në konvikte shtetërore të studentëve e përcakton ministri.

Neni 26

(1) Drejtori i konviktit të studentëve, nga radhët e të punësuarve në konviktin e studentëve, cakton person/persona përgjegjës për vendosjen e studentëve të pranuar.

(2) Konvikti i studentëve me studentët e pranuar lidh marrëveshje për shfrytëzimin e shërbimeve.

(3) Me marrëveshje për shfrytëzimin e shërbimeve rregullohen të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e ndërsjella të studentëve dhe të konviktit të studentëve.

Neni 27

(1) Gjatë shfrytëzimit të shërbimeve në konviktet e studentëve, studenti është i obliguar që t'i përmbahet rendit shtëpiak që miratohet nga këshilli drejtues.

(2) Studentëve që nuk i përmbahen rendit të përcaktuar shtëpiak mund t'u shqiptohet masë edukuese: paralajmërim me shkrim, paralajmërim para përjashtimit dhe ndalim për shfrytëzimin e shërbimeve të konviktit të studentëve.

(3) Masat edukuese paralajmërim me shkrim dhe paralajmërim para përjashtimit shqiptohen për shkelje më të lehta të rendit shtëpiak.

(4) Shkelje më e lehtë e rendit shtëpiak të konviktit të studentëve është:

- sjellja e pahijshme dhe e papërgjegjshme ndaj studentëve tjerë dhe të punësuarve në konviktin e studentëve,
- sjellja e papërgjegjshme ndaj pronës dhe inventarit të konviktit të studentëve me çfarë shkaktohet dëm më i vogël material,
- mosrespektimi i ndalimit për pirje duhanit në konviktin e studentëve,
- sjellja e pahijshme në restorantin e konviktit të studentëve,
- mosmbajtja e higjienës së dhomës dhe hapësirat e përbashkëta në konviktin e studentëve dhe
- lëshimi i muzikës së zhurmshme.

(5) Ndalim për shfrytëzimin e shërbimeve në konviktin e studentëve, mund të shqiptohet vetëm për shkelje më të rënda të rendit shtëpiak të konviktit të studentëve.

(6) Shkelje më e rëndë e rendit shtëpiak të konviktit të studentëve është:

- mosparaqitja në kohë e defekteve të pajisjeve që do të shkaktonin dëm material,
- futja dhe përdorimi i alkoolit dhe mjeteve narkotike,
- mosrespektimi i rregullave për mbrojtje nga sëmundja, zjarri, shpërthimi, veprimi i dëmshëm i helmeve dhe materieve tjera të rrezikshme dhe shkelja e rregullave për mbrojtjen e ambientit jetësor,
- sjellja ofenduese ose e dhunshme,
- sjellja e papërgjegjshme ndaj pronës dhe inventarit të konviktit të studentëve me çfarë shkaktohet dëm më i madh material,
- shpenzime të pashlyera për vendosje në konviktin e studentëve më shumë se tre muaj,
- shkaktimi i urrejtjes nacionale ose racore,
- mosrespektimi ose respektimi i pjesërishëm i masave për garantimin e sigurisë së inventarit të marrë,
- pengimi i kryerjes së kontrollit në dhomë nga persona të autorizuar të konviktit të studentëve,
- dhënia për shfrytëzim të dhomës personit tjetër për përfitime materiale dhe
- përsëritja e shkeljeve më të lehta të rendit shtëpiak.

(7) Ndalimi për shfrytëzimin e shërbimeve në konviktin e studentëve mund të shqiptohet në kohëzgjatje deri në një vit.

(8) Masa e shqiptuar edukative nga paragrafi (2) i këtij neni ndikon edhe në renditjen dhe pranimin e kandidatëve gjatë konkurrimit për pranim në konviktet e studentëve.

(9) Kundër masës së shqiptuar edukative, studenti ka të drejtë ankese në afat prej tetë ditësh nga dita e dorëzimit të vendimit, te organi i përcaktuar me statutin e institucionit.

(10) Vendimi ndaj ankesës është përfundimtar.

(11) Studentët që nuk i përmbahen rendit shtëpiak dhe/ose bëjnë dëm në konviktin e studentëve, krahas masës së shqiptuar edukative e kompensojnë edhe dëmin e kryer.

(12) Mënyra e kompensimit të dëmit rregullohet me statutin e konviktit të studentëve.

Neni 28

Mënyra e shqiptimit të masave edukative më afërsisht përcaktohet me statutin e konviktit të studentëve.

Neni 29

Qëndrimi në konviktin e studentëve i përfundon studentit nëse:

- e ka kryer arsimimin,
- nuk paraqitet në afatet e përcaktuara në konkurs,
- çregjistrohet,
- nuk e respekton rendin shtëpiak dhe
- në raste tjera të përcaktuara me ligj dhe statutin e konviktit të studentëve.

Neni 30

Dënimi fizik dhe maltretimi psikik i studentit është i ndaluar.

V. DOKUMENTACIONI DHE EVIDENCA

Neni 31

(1) Në konvikte të studentëve për studentët e pranuar mbahet dokumentacion dhe evidencë.

(2) Dokumentacioni në konviktet e studentëve është libri kryesor ku mbahet evidencë për studentët e pranuar.

(3) Evidencë në konviktet e studentëve është dosja që mbahet për çdo student të pranuar.

(4) Libri kryesor për studentët e pranuar është dokument me vlerë të përhershme.

(5) Libri kryesor në konviktet e studentëve mbahet dhe lëshohet në gjuhën maqedonase me përdorimin e alfabetit cirilik.

(6) Për studentët e pjesëtarëve të bashkësive që flasin gjuhë zyrtare, të ndryshme nga gjuha maqedonase, dosja mbahet dhe jepet në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik dhe në gjuhën dhe alfabetin që e flasin së paku 20% të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë dhe në njësitë e vetadministrimit lokal.

(7) Formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit dhe evidencës në konviktin e studentëve, i përcakton ministri.

VI. ÇMIMI PËR QËNDRIM TË STUDENTËVE NË KONVIKTET E STUDENTËVE

Neni 32

(1) Çmimi për vendosje dhe ushqim në konviktet shtetërore të studentëve përcaktohet në bazë të shpenzimeve reale në pajtim me normativat dhe standardet për këtë lloj të shërbimeve.

(2) Ministria për studentët që janë të vendosur në konvikt shtetëror të studentëve participon në çmimin e vendosjes dhe ushqimit deri në 50% nga çmimi i përcaktuar në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni, kurse dallimin deri në çmimin e përgjithshëm e paguan studenti.

(3) Ministria, për studentët që janë të vendosur në konvikt privat të studentëve, e me të cilin Ministria ka lidhur marrëveshje për vendosje të studentëve, participon në çmimin për vendosje dhe ushqim deri në 50% nga çmimi i përcaktuar në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni, kurse dallimin deri në çmimin e përgjithshëm e paguan studenti.

(4) Ministria për studentët që janë të vendosur në konvikt shtetëror të studentëve: fëmijë pa prindër dhe kujdes prindëror, fëmijë me nevoja të veçanta, fëmijë i prindërve të papunësuar, fëmijë i prindërve të vetëmbajtur, fëmijë i shfrytëzuesve të ndihmës sociale në para dhe ndihmës së përhershme në para dhe fëmijë i shfrytëzuesve të kompensimit në bazë të pushimit të marrëdhënies së punës për arsye afariste, në tërësi e paguan çmimin për vendosje dhe ushqim nga paragrafi (1) i këtij neni, përveç për fëmijë të prindërve të vetëmbajtur, fëmijë të prindërve të papunësuar dhe fëmijë të shfrytëzuesve të kompensimit në bazë të pushimit të marrëdhënies së punës për arsye afariste për të cilët të hyrat e përgjithshme në familje janë mbi rrogën minimale të përcaktuar në Republikën e Maqedonisë.

(5) Ministria për studentët që janë vendosur në konvikt privat të studentëve, e me të cilin Ministria ka lidhur marrëveshje për vendosje të studentëve fëmijë pa prindër dhe kujdes prindëror, fëmijë me nevoja të veçanta, fëmijë të prindërve të vetëmbajtur, fëmijë të shfrytëzuesve të ndihmës sociale në para dhe ndihmës së përhershme në para dhe fëmijë të shfrytëzuesve të kompensimit në bazë të pushimit të marrëdhënies së punës për arsye afariste, në tërësi e paguan çmimin e vendosjes dhe ushqimit nga paragrafi (1) i këtij neni, përveç për fëmijë të prindërve vetëmbajtës, fëmijë të prindërve të papunësuar dhe fëmijë të shfrytëzuesve të kompensimit në bazë të pushimit të marrëdhënies së punës për arsye afariste për të cilët të hyrat e përgjithshme në familje janë mbi rrogën minimale të përcaktuar në Republikën e Maqedonisë.

(6) Normativat dhe standardet nga paragrafi (1) i këtij neni i përcakton ministri, me propozim të komisionit profesional që e formon ministri, i përbërë nga dy përfaqësues të Agjencisë për Ushqim dhe Veterinari të Republikës së Maqedonisë, dy përfaqësues nga Ministria dhe një përfaqësues nga Dhoma e Inxhinierëve dhe Arkitekteve të Maqedonisë.

Neni 33

(1) Lartësia e çmimit për vendosje dhe ushqim në konviktet shtetërore të studentëve përcaktohet me programin nga neni 8 i këtij ligji.

(2) Lartësinë e çmimit për vendosje dhe ushqim në konvikt privat të studentëve e përcakton organi i përcaktuar nga themeluesi.

(3) Ministria mund t'u ndajë mjete konvikteve shtetërore të studentëve për shpenzime për punë rrjedhëse në aspekt të regjive për ngrohje, energji elektrike, ujit të harxhuar etj., nëse krijohen situata të paparashikueshme që i kanë rritur shpenzimet, e që nuk kanë mundur të parashihen dhe planifikohen në buxhetet e tyre, pas parashtrimit të kërkesës me shkrim me arsyetim nga konvikti shtetëror i studentëve në Ministri dhe pas pëlqimit paraprak të Ministrisë së Financave.

(4) Mjetet nga paragrafi (3) i këtij neni ndahen pas vendimit të marrë paraprakisht nga themeluesi.

VI -a. TË PUNËSUARIT NË KONVIKT STUDENTOR

Neni 33-a 3

(1) Në konvikte studentore vendet e punës së të punësuarve grupohen:

- Nëpunës administrativë dhe
- Persona ndihmës teknikë.

(2) Të punësuarit në konvikte studentore që kryejnë punë nga natyra administrative kanë status të nëpunësve administrativë.

(3) Për të punësuarit nga paragrafi (2) i këtij neni përcaktohen këto kategori dhe nivele të vendeve të punës:

- kategoria B – udhëheqëse
- niveli B4 udhëheqës i seksionit (udhëheqës për vendosje, udhëheqës për financa dhe kontabilitet, udhëheqës për punë normative juridike dhe resurse njerëzore, udhëheqës për ushqim),
- kategoria V – profesionalë
- niveli V1 Këshilltar (këshilltar për punë normative juridike, këshilltar - kontabilist, këshilltar për furnizim të ushqimit, këshilltar për vendosje dhe të tjerë),
- niveli V2 bashkëpunëtor i lartë (drejtor i konviktit, sekretar - arkëtar, bashkëpunëtor i lartë për furnizime publike, IT inxhinier dhe teknolog për ushqim, bashkëpunëtor i lartë për vendosje, bashkëpunëtor i lartë për furnizim të ushqimit, bashkëpunëtor i lartë për ushqim, bashkëpunëtor i lartë për mbrojtje gjatë punës, preventivë dhe menaxhim me kriza, bashkëpunëtor i lartë për jetë

kulturore-artistike, bibliotekist e të tjerë) dhe

- niveli V3 bashkëpunëtor (bashkëpunëtor për punë normative juridike, bashkëpunëtor për resurse njerëzore e të tjerë) dhe

- kategoria G –profesional-ndihmës

- niveli G1 referent i pavarur (arkëtar, likuidues, referent i pavarur për punë administrative, arkivist, referent i pavarur për furnizime publike, referent i pavarur për punë të kontabilitetit, magazinues, referent i pavarur për vendosje, referent i pavarur për ushqim, referent i pavarur për turizëm, referent i pavarur për furnizim të ushqimit dhe referent i pavarur për shërbime ushqimore hoteliere e të tjerë),

- niveli G2 referent i lartë (referent i lartë për ushqim e të tjerë),

- niveli G3 referent (referent për ushqim e të tjerë) dhe

- niveli G4 referent i ri (referent i ri për ushqim e të tjerë).

(4) Të punësuarit në konvikte studentore që kryejnë punë ndihmëse teknike kanë status të personave teknik ndihmës dhe për to zbatohen dispozitat nga ky ligj, Ligji për të punësuarit në sektorin publik dhe dispozitat e përgjithshme për marrëdhënie pune.

(5) Për të punësuarit nga paragrafi (4) i këtij neni përcaktohen këto nëngrupe, kategori dhe nivele të vendeve të punës:

- nëngrupi 1 kategoria A niveli A1 pastrues, ndezës i kazanëve me avull, punëtor për mirëmbajtje të konviktit, kopshtar, haus mjeshtër e të tjerë,

- nëngrupi 2 kategoria A niveli A1 rojtar, portier e të tjerë,

- nëngrupi 3 kategoria A niveli A1 shofer e të tjerë,

- nëngrupi 4 kategoria A niveli A1 shef i kuzhinës, kryekuzhinier, kuzhinier, ndihmës kuzhinier, përgatitës i ushqimit, enëlarës, punëtor në kuzhinë e të tjerë dhe

- nëngrupi 5 kategoria A niveli A1 sekretar teknik, punëtor në depo, korrier e të tjerë.

Neni 33-b [4](#)

Drejtori, me mendim paraprak të Ministrisë për shoqëri informatike dhe administratë dhe pëlqim paraprak nga Ministria për arsim dhe shkencë miraton plan vjetor për punësim në konviktet studentore shtetërore për vitin e ardhshëm në pajtim me Ligjin për të punësuarit në sektorin publik.

VII. MENAXHIMI DHE UDHËHEQJA ME KONVIKTET E STUDENTËVE

Neni 34

(1) Organi i menaxhimit në konviktin shtetëror të studentëve është këshilli drejtues.

(2) Këshilli drejtues i konviktit shtetëror të studentëve përbëhet nga shtatë anëtarë, si vijon: tre përfaqësues nga themeluesi, dy nga radhët e të punësuarve në konviktin e studentëve, një përfaqësues i shoqatës së studentëve nga universiteti ku konvikti i studentëve është anëtar shoqëruës dhe një përfaqësues i universitetit ku konvikti i studentëve është anëtar shoqëruës, në bazë të parimeve të profesionalitetit dhe kompetencës.

- (3) Përfaqësuesit nga shoqata e studentëve të universitetit, nga themeluesi dhe nga Ministria nuk mund të emërohen nga radhët e të punësuarve në konviktin shtetëror të studentëve.
- (4) Përfaqësuesit e themeluesit për konviktet shtetërore të studentëve i emëron dhe shkarkon Qeveria.
- (5) Përfaqësuesit e të punësuarve, të shoqatës së studentëve nga universiteti dhe të universitetit zgjidhen dhe shkarkohen në mënyrë të përcaktuar me statutet e konvikteve të studentëve dhe universiteteve, përkatësisht statutet e shoqatave të studentëve.
- (6) Anëtarët e këshillit drejtues emërohen në periudhë prej katër viteve, me të drejtë rizgjedhjeje.
- (7) Përfaqësuesi i shoqatës së studentëve të universitetit, emërohen për periudhë deri sa është me status të studentit të rregullt.
- (8) Këshilli drejtues nga radhët e anëtarëve të saj e zgjedh kryetarin.
- (9) Vendimet e këshillit drejtues miratohen me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të këshillit.

Neni 35

Këshilli Drejtues i konviktit shtetëror të studentëve:

- e miraton statutin,
- e miraton programin vjetor për punë dhe e dorëzon te Ministria më së voni deri më 31 dhjetor të vitit rrjedhës për vitin e ardhshëm,
- miraton raport për punën në vitin paraparak dhe e dorëzon te Ministria më së voni deri më 31 janar të vitit rrjedhës,
- miraton plan vjetor financiar dhe e dorëzon te Ministria deri më 30 nëntor të vitit rrjedhës për vitin e ardhshëm,
- miraton llogari përfundimtare dhe e dorëzon te Ministria,
- shpall konkurs publik për zgjedhje të drejtorit,
- bën intervistë me kandidatët për drejtor,
- propozon kandidat për drejtor nga kandidatët e paraqitur për drejtor në konkursin e shpallur publikë për emërimin e drejtorit,
- propozon çmim për vendosje dhe ushqim,
- vendos për kundërshtime dhe ankesa të të punësuarve në konviktin e studentëve,
- vendos për kundërshtime dhe ankesa të studentëve dhe
- kryen edhe punë tjera të përcaktuara me këtë ligj dhe statutin e konviktit shtetëror të studentëve.

Neni 36

Organin e menaxhimit në konviktin privat të studentëve dhe fushëveprimin e tij i përcakton themeluesi.

Neni 37

(1) Drejtori është organ udhëheqës i konviktit të studentëve dhe është përgjegjës për ligjshmërinë në punë dhe për punën materiale-financiare të konviktit të studentëve.

5

(2) Për drejtor të konviktit shtetëror mund të zgjidhet personi i cili i plotëson këto kushte:

- 1) është shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- 2) në momentin e emërimit me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim ose sanksion kundërvajtës ndalim për ushtrim të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- 3) ka marrë së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallë të kryer VII/ të arsimit;
- 4) ka minimum pesë vjet përvojë pune;
- 5) posedon një nga certifikatat ose dëshmitë e pranuar ndërkombëtare vijuese për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet: 6
 - TOEFEL IBT së paku 74 pikë,
 - IELTS (IELTS) – së paku 6 pikë,
 - ILEC (ILEC) (Cambridge English: Legal) - së paku niveli B2 (B2),
 - FCE (FCE) (Cambridge English: First) – i dhënë,
 - BULATS (BULATS) – së paku 60 pikë ose
 - APTIS (APTIS) – së paku niveli B2 (B2) dhe
- 6) të ketë dhënë test psikologjik dhe test për integritet.

(3) Mandati i drejtorit të konviktit shtetëror të studentëve është katër vite me të drejtë rizgjedhjeje.

(4) Nëse drejtori i konviktit të studentëve, ka qenë i zgjedhur dy mandate të njëpasnjëshme drejtor i konviktit të studentëve, ai nuk mund të zgjidhet më drejtor i atij konvikti të studentëve.

(5) Drejtorin e konviktit shtetëror të studentëve e emëron dhe shkarkon ministri, me propozim të këshillit drejtues të konviktit të studentëve.

(6) Drejtorin e konviktit privat të studentëve e emëron dhe shkarkon themeluesi.

Neni 38

(1) Drejtori i konviktit të studentëve e organizon dhe udhëheq punën e konviktit të studentëve, në mënyrë të pavarur miraton vendim nga fushëveprimi i punës së tij, i përcaktuar me ligj dhe aktet e konviktit të studentëve dhe e përfaqëson para personave të tretë.

(2) Në realizimin e obligimeve dhe udhëheqjen nga paragrafi (1) i këtij neni, drejtori:

- propozon program vjetor për punë dhe ndërmerr masa për zbatimin e tij,
- zbaton vendime të këshillit drejtues,
- kryen pagesë të mjeteve në pajtim me planin vjetor financiar të konviktit të studentëve,
- kryen zgjedhjen e të punësuarve,
- kryen vendosjen e studentëve të pranuar,

- i propozon Ministrisë numrin e studentëve që duhet të qëndrojnë në vitin vijues studimor,
- vendos për sistemimin e të punësuarve,
- vendos për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të të punësuarve,
- parashtron raport për realizimin e programit vjetor dhe për punën materiale financiare të institucionit të këshilli drejtues dhe të Ministria dhe
- kryen edhe punë tjera të parapara me ligj, statut dhe akte tjera të konviktit të studentëve.

Neni 39

- (1) Këshilli Drejtues i konviktit shtetëror të studentëve, tre muaj para kalimit të mandatit të drejtorit ekzistues, miraton vendim për shpalljen e konkursit publik për zgjedhjen e drejtorit.
- (2) Në shpalljen publike që publikohet në së paku tre gazeta ditore të cilat botohen në të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë, nga të cilat një nga gazetatat që botohen në gjuhën që e flasin së paku 20% nga qytetarët që flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase. përmbahen kushtet që duhet t'i plotësojë kandidati për drejtor, dokumentacioni i nevojshëm, kohëzgjatja e konkursit publik dhe afati në të cilin do të kryhet përzgjedhja. [7](#)
- (3) Kandidatët e paraqitur duhet t'i dorëzojnë dokumentet e nevojshme në pajtim me konkursin të këshilli drejtues.
- (4) Dokumentet e arritura i shqyrton komisioni tre anëtarësh nga radhët e anëtarëve të këshillit drejtues që punon në pajtim me statutin e konviktit të studentëve.
- (5) Komisioni detyrohet që në afat prej pesë ditëve pas përfundimit të konkursit t'i shqyrtojë dokumentet e arritura.
- (6) Kandidatëve që nuk i plotësojnë kushtet e parapara në konkurs u kthehen dokumentet me arsyetim.
- (7) Këshilli drejtues mund të kërkojë dokumente shtesë nga kandidatët që i plotësojnë kushtet, në pajtim me dispozitat e statutit të konviktit të studentëve.
- (8) Anëtarët e këshillit drejtues kryejnë intervistë me kandidatët që i plotësojnë kushtet për drejtor.
- (9) Këshilli drejtues i konviktit shtetëror të studentëve, në afat prej shtatë ditëve nga intervista e realizuar me kandidatët i propozon ministrin kandidat për drejtor.
- (10) Ministri, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të propozimit për kandidat për drejtor, e kryen zgjedhjen e drejtorit të konviktit shtetëror të studentëve.
- (11) Kandidatët të cilët nuk janë zgjedhur në afat prej tetë ditëve nga dita e pranimit të vendimit për zgjedhje kanë të drejtë të ankesës në lidhje me zbatimin e procedurës për zgjedhjen e drejtorit në Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë.

(12) Kundër vendimit të Komisionit nga paragrafi (11) i këtij neni, kandidati ka të drejtë të ngritë procedurë administrative në gjykatën kompetente.

Neni 40

(1) Drejtorit të konviktit të studentëve i ndërpritet mandati nëse:

- këtë vetë e kërkon,
- e humb në mënyrë të përhershme aftësinë për kryerjen e detyrës së drejtorit dhe
- me mbushjen e moshës 64 vjeç.

(2) Drejtori i konviktit shtetëror të studentëve shkarkohet para kalimit të mandatit, nëse:

- është kryer shkelje gjatë zbatimit të ligjeve, rregullave tjera dhe akteve të përgjithshme, të përcaktuara nga Inspektorati Shtetëror i Arsimit,
- nuk e realizon programin për punë të konviktit të studentëve,
- me faj të tij i është shkaktuar dëm konviktit të studentëve ose studentëve dhe Republikës,
- lejon organizim të veprimtarive dhe aktiviteteve që janë në kundërshtim me programin për punë,
- lejon pagesë të mjeteve të cilat nuk janë të përcaktuara në planin vjetor financiar të konviktit të studentëve dhe
- më raste tjera të përcaktuara me ligj.

Neni 41

(1) Nëse ekzistojnë njohuri të caktuara për veprim të drejtorit në kundërshtim me ligjin dhe statutin e konviktit të studentëve, këshilli drejtues cakton mbledhje në të cilën miratohet konkluzion në formë të shkruar që i dorëzohet drejtorit.

(2) Drejtori ka të drejtë që në afat prej shtatë ditëve nga pranimi të prononcohet për konstatimet në konkluzion.

(3) Nëse këshilli drejtues nuk e pranon prononcimin e drejtorit, cakton mbledhje në afat prej tri ditësh dhe në prani të përfaqësuesve nga Inspektorati Shtetëror i Arsimit dhe universiteti ku konvikti i studentëve është anëtar shoqërues kryen intervistë me drejtorin. Përfaqësuesi i Inspektoratit Shtetëror të Arsimit jep mendim për arsyeshmërinë e shkarkimit të drejtorit.

(4) Nëse këshilli drejtues vlerëson se është e domosdoshme, dorëzon propozim për shkarkimin e drejtorit të ministri.

(5) Drejtori i shkarkuar në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimi të vendimit për shkarkim ka të drejtë në ankesë në lidhje me zbatimin e procedurës për shkarkim në Komisionin shtetëror për vendimmarrje në procedurë administrative dhe procedurë të marrëdhënies së punës në shkallë të dytë.

(6) Kundër vendimit të Komisionit nga paragrafi (5) i këtij neni, kandidati ka të drejtë të ngritë kontest administrativ në gjykatën kompetente.

Neni 42

(1) Ministri, në afat prej tri ditësh nga dita e shkarkimit të drejtorit, emëron ushtrues detyrë të drejtorit nga radhët e të punësuarve në konviktin e studentëve i cili i plotëson kushtet për drejtor.

(2) Ushtruesi i detyrës drejtor i kryen punët deri në emërimin e drejtorit të ri, por jo më gjatë se gjashtë muaj nga dita e emërimit të tij.

Neni 43

Drejtori i cili nuk është rizgjedhur në konkurs publik ose është i shkarkuar jo me faj të tij para kalimit të mandatit për kohën për të cilën është zgjedhur, sistemohet në konvikt të studentëve në vend pune përkatës me përgatitjen e tij profesionale.

Neni 44

(1) Në konviktet shtetërore të studentëve formohet Këshilli i Banorëve të cilin e përbejnë përfaqësues nga studentët të cilët qëndrojnë në konviktin e studentëve.

(2) Këshilli i Banorëve i kryen punët në vijim:

- shqyrton çështje dhe jep mendim për përmirësim të jetës dhe punës së studentëve në konviktin e studentëve,
- bashkëpunon me drejtorin dhe me të punësuar tjerë në konviktin e studentëve dhe
- kryen punë tjera me interes për qëndrimin e studentëve në konvikt.

(3) Puna, numri i anëtarëve, mënyra e zgjedhjes dhe organizimi i këshillit të banorëve përcaktohet me statutin e konviktit të studentëve.

VIII. FINANCIMI I VEPRIMTARISË NË KONVIKTET E STUDENTËVE

Neni 45

Mjetet për financim të konvikteve shtetërore të studentëve sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë në pajtim me Ligjin për buxhete, Ligjin për realizimin e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë, si dhe nga shfrytëzuesit e shërbimeve.

Neni 46

Për realizimin e veprimtarisë së konvikteve private të studentëve mjetet i siguron themeluesi.

Neni 47

(1) Konviktet e studentëve mund të marrin mjete edhe nga:

- participimi i shfrytëzuesve të shërbimeve,
- shitja e prodhimeve dhe shërbimeve që janë rezultat i veprimtarisë plotësuese dhe
- legate, donacione, testamente dhe burime tjera.

(2) Mjetet nga paragrafi (1) të këtij neni do të shfrytëzohen në pajtim me planin financiar të konviktit të studentëve.

IX. DHËNIA E BURSIVE TË STUDENTËVE

Neni 48

(1) Me qëllim të zbulimit, stimulimit dhe kultivimit të studentëve me prirje nga sfera të ndryshme të shkencës, teknikës, kulturës, artit dhe sportit, Ministria ndan bursa për studentë.

(2) Kriteria kryesore për ndarjen e bursave janë:

- suksesi i arritur në arsim,
- programi studimor në të cilin është regjistruar studenti dhe
- mundësitë materiale të studentëve dhe familjeve të tyre.

Neni 49

(1) Ndarja e bursave të studentëve për studentë të cilët studiojnë në Republikën e Maqedonisë bëhet në bazë të konkursit që e shpall Ministria.

(2) Ndarja e bursave të studentëve për studentë të cilët studiojnë jashtë vendit bëhet në bazë të konkursit që e shpall Ministria.

(3) Konkurset nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, i përmbajnë llojin, numrin dhe lartësinë e bursave, si dhe dokumentet e nevojshme dhe afatet për ndarjen e bursave.

(4) Nga numri i përgjithshëm i bursave nga paragrafi (1) i këtij neni 50% janë për studentë nga kategoritë sociale, 30% janë për studentët të cilët kanë arritur sukses të veçantë dhe 20% janë për studentë të cilët janë të regjistruar në programe studimore nga sferat shkencore të shkencave natyrore-matematikore, teknike teknologjike, bioteknike dhe/ose të mjekësisë.

(5) Llojin e bursave të studentëve dhe mënyrën e ndarjes së bursave të studentëve i përcakton ministri.

(6) Kundër aktvendimeve të Ministrisë për ndarjen e bursave të studentëve, në afat prej tetë ditëve nga dita e pranimit të aktvendimit, mund të parashtrohet ankesë të Komisioni shtetëror për vendimmarrje në procedurë administrative dhe procedurë të marrëdhënies së punës në shkallë të dytë.

(7) Komisioni shtetëror për vendimmarrje në procedurë administrative dhe procedurë të marrëdhënies së punës në shkallë të dytë vendos për ankesën e parashtruar në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të ankesës.

Neni 50

Shfrytëzues të bursave të studentëve mund të jenë studentë të rregullt, shtetas të Republikës së Maqedonisë, nëse i plotësojnë kushtet dhe kriteret në pajtim me këtë ligj.

Neni 51

(1) Ministria mund t'u ndajë bursa shtetasve të huaj në pajtim me vendim të Qeverisë, nëse ndarja e bursës është me interes për Republikën.

(2) Mënyrën e ndarjes së bursave të studentëve nga paragrafi (1) i këtij neni, e përcakton ministri.

Neni 52

Ministria mund të participojë me mjete në shoqata, lidhje, institucione shkencore edhe organizata tjera të cilat krijojnë kushte për zbulimin, stimulimin, zgjerimin dhe thellimin e njohurive nga sfera e shkencës, teknikës, kulturës, artit dhe sportit të studentët, në pajtim me ligjin.

X. MBIKËQYRJA

Neni 53

(1) Mbikëqyrje mbi zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe rregullave të miratuara në bazë të këtij ligji kryen Ministria.

(2) Mbikëqyrje inspektuese mbi zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe rregullave të miratuara në bazë të këtij ligji kryen Inspektorati Shtetëror i Arsimit, në pajtim me ligj.

(3) Inspektorati Shtetëror i Arsimit, në afat prej 30 ditëve nga dita e përfundimit të vendosjes së studentëve në konviktin shtetëror të studentëve, kryen mbikëqyrje inspektuese dhe në afat prej 60 ditëve nga dita e përfundimit të vendosjes së studentëve në konviktin shtetëror të studentëve parashtron raport te Ministria dhe Qeveria.

Neni 54

Kur Ministria do të vlerësojë se statuti ose akti tjetër i konviktit të studentëve nuk është në pajtim me Kushtetutën ose ligjin, ka të drejtë ta ndërpresë zbatimin e aktit deri në miratimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë.

Neni 55

Konvikti i studentëve detyrohet që të mundësojë kryerje të papenguar të mbikëqyrjes profesionale dhe qasje në dokumentacionin dhe evidencën që mbahet në konviktin e studentëve.

Neni 56

(1) Nëse gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese, inspektori shtetëror i arsimit përcakton se për herë të parë është bërë parregullsi nga neni 58 paragrafët (1) alineja 2 dhe (2) alineja 4 të këtij ligji, është i detyruar të përpilojë procesverbal në të cilin do ta përcaktojë parregullsinë e kryer me sugjerim për mënjanimin e parregullsisë së përcaktuar në afat prej tetë ditësh dhe me dorëzim të njëkohshëm të ftesës për zbatimin e edukimit të personit ose konviktit të studentëve ku është përcaktuar parregullsia gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese.

(2) Formën dhe përmbajtjen e ftesës për edukim, si dhe mënyrën e zbatimit të edukimit i përcakton ministri.

(3) Edukimin e organizon dhe zbaton Inspektorati Shtetëror i Arsimit, në afat jo më të gjatë se tetë ditë nga dita e zbatimit të mbikëqyrjes inspektuese.

(4) Edukimi mund të zbatohet për më shumë parregullsi të përcaktuara të njëjta ose të njëllajta për një ose më shumë persona, përkatësisht për një ose më shumë konvikte të studentëve.

(5) Nëse në terminin e caktuar personi ose konvikti i studentëve për të cilin zbatohet edukimi nuk paraqitet në edukim, do të konsiderohet se edukimi është zbatuar.

(6) Nëse personi ose konvikti i studentëve për të cilin zbatohet edukimi paraqitet në edukimin e caktuar dhe e përfundon atë, do të konsiderohet se është edukuar në lidhje me parregullsinë e përcaktuar.

(7) Nëse inspektori shtetëror i arsimit gjatë zbatimit të mbikëqyrjes kontrolluese konstaton se janë mënjeluar parregullsitë e përcaktuara nga paragrafi (1) i këtij neni, miraton konkluzion me të cilin e ndërpret procedurën e mbikëqyrjes inspektuese.

(8) Nëse inspektori shtetëror i arsimit gjatë zbatimit të mbikëqyrjes kontrolluese konstaton se nuk janë mënjeluar parregullsitë e përcaktuara nga paragrafi (1) i këtij neni, parashtron kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse në gjykatën kompetente.

(9) Inspektorati shtetëror i arsimit mban evidencë për edukimin e zbatuar në mënyrë të përcaktuar nga ministri.

Neni 57

Inspektori shtetëror i arsimit për kontrollet e kryera përpilon raporte tremujore dhe i publikon në ueb faqen e Inspektoratit Shtetëror të Arsimit në pasqyrë të unifikuar tremujore.

XI. DISPOZITA KUNDËRVAJTËSE

Neni 58

(1) Gjohë në shume prej 2.000 deri në 2.500 euro në kundërvlere me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje të punësuarit në konviktin e studentëve, nëse:

- e ndëshkon fizikisht studentin, përkatësisht psikikisht e keqtrajton (neni 30),
- dokumentacionin dhe evidencën e mban në kundërshtim me nenin 31 të këtij ligji dhe
- e vendos studentin në kundërshtim me nenin 38 paragrafi (2) alineja 5 të këtij ligji.

(2) Gjohë në shumë prej 3.000 deri në 5.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje konviktit të studentëve, nëse:

- lejon organizim dhe veprim të partive politike dhe organizatave fetare dhe vendos shenja partiake dhe fetare (neni 5),
- fillon kryerjen e veprimtarisë para miratimit të aktvendimit për përmbushjen e kushteve për fillim të punës dhe kryerjes së veprimtarisë (neni 19 paragrafi (1)),
- shfrytëzon vulë me përmbajtje joadekuate (neni 6 paragrafi (2)),
- nuk miraton program vjetor për punë (neni 23 paragrafët (2) dhe (3)),
- e ndalon ose pengon inspektorin shtetëror të arsimit në kryerjen e punëve të inspeksionit arsimor, nuk ia jep të dhënat e nevojshme dhe nuk i zbaton masat e përcaktuara (neni 56) dhe
- lejon pagesë të mjeteve të cilat nuk janë përcaktuar në planin financiar vjetor (neni 38 paragrafi (2) alineja 3).

(3) Gjohë në shumë prej 2.000 deri në 3.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet edhe personit përgjegjës në personin juridik për kundërvajtjet nga paragrafi (2) i këtij neni.

(4) Gjohë në shumë prej 4.000 deri në 6.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit fizik ose juridik, nëse themelon institucion privat në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji.

(5) Gjohë në shumë prej 2.500 deri në 3.500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet edhe personit përgjegjës në personin juridik për kundërvajtje nga paragrafi (4) i këtij neni.

(6) Gjohë në shumë prej 7.500 deri në 15.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet edhe personit përgjegjës në personin juridik, nëse e vendos studentin në kundërshtim me nenin 38 paragrafi (2) alineja 5 të këtij ligji.

(7) Gjohë në shumë prej 5.000 deri 7.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit të punësuar te personi juridik i cili është i caktuar për vendosjen e studentëve të pranuar, nëse e vendos studentin në kundërshtim me nenin 26 paragrafi (1) të këtij ligji.

Neni 59

Procedurën kundërvajtëse për kundërvajtje të parapara në këtë ligj e udhëheq gjykata kompetente.

Neni 60

Para parashtrimit të kërkesës për procedurë kundërvajtëse për kundërvajtjet e parapara në këtë ligj, Inspektorati Shtetëror i Arsimit udhëheq procedurë për barazim në pajtim me Ligjin për kundërvajtje.

XII. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 61

Konviktet ekzistuese të studentëve në afat prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do ta harmonizojnë organizmin, punën, statutet dhe aktet tjera të përgjithshme të tyre me dispozitat e këtij ligji.

Neni 62

Drejtorët e konvikteve shtetërore të studentëve të emëruar para hyrjes në fuqi të këtij ligji vazhdojnë t'i kryejnë funksionet e tyre deri në kalimin e kohës për të cilën janë emëruar.

Neni 63

Kryetarët dhe anëtarët e këshillave drejtuese të konvikteve shtetërore të studentëve të zgjedhur, përkatësisht të emëruar para hyrjes në fuqi të këtij ligji vazhdojnë t'i kryejnë funksionet e tyre deri në kalimin e kohës për të cilën janë emëruar.

Neni 64

Qendra ekzistuese Shtetërore e Studentëve "Skopje" në Shkup e vazhdon punën si Konvikt Shtetëror i Studentëve "Skopje" në Shkup.

Neni 65

Aktet nënligjore të parapara me këtë ligj, do të miratohen në afat prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 66

Procedurat e filluara para ditës së hyrjes në fuqi të këtij ligji do të përfundojnë në pajtim me dispozitat e Ligjit për standardin e nxënësve dhe studentëve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 37/98 dhe 40/2003).

Neni 67

Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji shfuqizohet Ligji për standardin e nxënësve dhe studentëve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 37/98 dhe 40/2003).

Neni 68

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".